



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 8 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6, Nenit 14 paragrafi 2 nën paragrafi 2.6 dhe 2.16, Nenit 25 dhe 43 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 03/L-185);
- Rregullën për vendosjen e Çmimeve të Gjenerimit (Rregulla për Çmimet e Gjenerimit) dhe,
- Aplikacionin e KEK-Gjenerimit të dorëzuar në kuadër të Shqyrtimit të Shtatë të Tarifave të Energjisë Elektrike (SHTET7) me dokumentacionin relevant sqarues;
- Vendimin nr. V_516_2013 për të Hyrat Maksimale të Lejuara për operatorët e licencuar për prodhim të energjisë elektrike-Termocentrali Kosova A dhe Termocentrali Kosova B (Gjeneratorët e Rregulluar); dhe
- Kërkesën e datës 16 prill 2013 të KEK SH.A drejtuar ZRRE-së për miratim të çmimeve të rregulluara të gjenerimit.

në seancën e mbajtur më 02 maj 2013 nxori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHEN** çmimet e rregulluara që do të zbatohen nga operatori i licencuar i Termocentralit Kosova A dhe operatorit i licencuar Termocentrali Kosova B (Gjeneratorët e Rregulluar) nga data 1 prill 2013.

ARSYETIM

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka pranuar nga Korporata e Energjisë Elektrike e Kosovës SH.A. (KEK) kërkesën për shqyrtim të çmimeve të rregulluara të KEK Sh.A – Divizioni i Gjenerimit.
 - Në marrjen e vendimit të tij për MAR që do të mbulohet nga Gjeneratorët e Rregulluar përmes çmimeve të rregulluara, ZRRE ka marrë parasysh dokumentet si në vijim që janë nxjerrë dhe publikuar në ueb faqen e saj:
 - Vlerësimi fillestar i formularëve të raportimit të KEK-ut, i nxjerrë me datë 19 tetor 2012;
 - Vlerësimi i përkohshëm – Vlerësim i detajuar i Gjenerimit të KEK-ut, i publikuar me datë 8 janar 2013;
 - Vlerësimi i përfundimtar – Vlerësim i detajuar i Gjenerimit të KEK-ut, i publikuar me datë 22 shkurt 2013;
 - Vlerësimi i përfundimtar-Pasqyrë, i publikuar me datë 22 shkurt 2013.
- II.** Duke marrë parasysh dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi dhe pas shqyrtimit të të gjitha shënimeve dhe dokumenteve përkatëse, Bordi i ZRRE-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



III. Struktura e ngarkesave për energji dhe kapacitet për KEK- Gjenerimin, që do të zbatohet nga data 1 prill 2013 deri më 31 mars 2014 është si në tabelë e mëposhtme.

Elementi Tarifor	Njësia	Ngarkesa
Ngarkesa për Energji	€/MWh	6.09
Ngarkesa për Kapacitet	€/muaj	9,818,438

IV. Të licencuarit duhet t'i publikojnë ngarkesat e miratuara nga Bordi i ZRRE-së.

V. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.

VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e aprovimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe do të publikohet në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtar

Krenar Bujupi, anëtar